



## UNIVERSITETI “MESDHETAR I SHQIPËRISË”

### UDHËZUES PËR STUDENTIN

Viti Akademike 2024/2025

(Material ndihmës, nga Statuti, Rregullorja e dokumenteve të tjera ligjore Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë)

(LICENSUAR ME VENDIM TË KM, DT 19.02.2009, AKREDITUAR ME VENDIMIN NR. 62, DATË 18.12.2020 TË BORDIT TE AKREDITIMIT. AFATI PËRFUNDIMTAR I VLEFSHMËRISË SË AKREDITIMIT TË UNIVERSITETIT "MESDHETAR I SHQIPËRISË" ËSHTË 17/12/2026.)

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përfaqëson një përpjekje unike në fushën e arsimit në Shqipëri. Që në themelimin e vet ka vendosur si qëllimin kryesor edukimin e studentëve me një frymë të re, e cila është aq e nevojshme për progresin e individit dhe njëkohësisht edhe të shoqërisë. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka në përbërje të saj një staf akademik ndër më elitarët në vend, ku bashkërendohet eksperiencia e një brezi me vitalitetin e një tjetri. Të gjithë pedagogët e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, janë të specializuar në Universitetet më në zë evropiane dhe amerikane, dhe janë të dedikuar ndaj studentëve për të ofruar të gjithë përvojën e tyre. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë gjendet në një nga zonat më të preferuara të Tiranës dhe vendos në dispozicion të studentëve një godinë të re, moderne me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor të një niveli të lartë.

#### 1. Struktura e Mesdhetarit

		Salla
Rektori	Akademik i Asociuar Prof. Dr. Adrian Civici	405
Zv. Rektor	Prof. Greta Angjeli	403
	Prof. Nevila Rama	404
	Prof. Përparim Kabo	205
	Prof. Nikolin Pano	205
	Prof. Arben Cici	C9
Administratori	Ilir Hebovija	402

Tel: +355 68 50 47301 • +355 69 62 28401

E-Mail: Informacion: [info@umsh.edu.al](mailto:info@umsh.edu.al) • Aplikime: [aplikim@umsh.edu.al](mailto:aplikim@umsh.edu.al)

[www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)

	FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE (FSHE)	Zyra	FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE (FDSHH)	Zyra	FAKULTETI I INFORMATIKËS (FI)	Zyra	FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE (FSHM)	Zyra
	Dekani	105	Dekani	C10	Dekani	105	Dekani	D301
	Prof. Dr. Lindita Milo		Prof. Dr. Ksenofon Krisafi	C10	Prof. Dr. Dhimitër Tole		Prof. Dr. Mihal Tase	
1	Departamenti i Financë Bankë dhe Kontabilitet	305	Departamenti i së Drejtës	C10	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	C13	Departamenti i Infermieristikës	D302
2	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	305	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	C10	Departamenti i Informatikës së Biznesit	C13	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	D302
3	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	305	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	C8	Qendra e Inovacionit dhe e Teknologjive Digjitale	201	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	D303
								D103
4							Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	D103

Njësia	Përgjegjës	Salla
Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierrës	Prof. Holta Heba	C9
Zyra ERASMUS	Prof. Elton Skëndo	C8
Këshilli Studentor	Sara Betoja	C5
Biblioteka	Znj. Dafina Meshi	B

## 2. Procedurat dhe Rregullat

Tel: +355 68 50 47301 • +355 69 62 28401

E-Mail: Informacion: [info@umsh.edu.al](mailto:info@umsh.edu.al) | Aplikime: [aplikim@umsh.edu.al](mailto:aplikim@umsh.edu.al)

[www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)



## A. PROCESI MESIMOR

- 1) **FREKUENTIMI I PROCESIT MËSIMOR** në të gjitha programet e studimit Bcs, MP dhe Msc është i **DETYRUESHËM** në më shumë se 75% të seminareve dhe të leksioneve të programuara për çdo lëndë. Në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi studenti **HUMBET** të drejtën e hyrjes në provim në cilindo sezon, dhe është i detyruar ta **RI-FREKUENTOJE** lëndën në vitin e ardhshëm mesimor kundrejt penaltetit prej 11000 (njëmbëdhjetë mijë) Lekë.

Studentët kanë në përdorim SMS (Sistemi i Menaxhimit të Studentit) ku ndjek në çdo moment ecurinë e tij, si nga ana e procesit akademik ashtu dhe detyrimet e tjera që ka ndaj Universitetit.

Studenti e ka detyrim regjistrimin në provime nëpërmjet sistemit me anë të llogarisë personale, e cila aktivizohet me fillimin e studimeve.

Regjistrimi në provime është përgjegjësi e plotë e studentit, prandaj ai është i detyruar gjatë gjithë procesit akademik të kontrollojë llogarinë dhe ta mirëmbajë atë.

### 2) **VLERËSIMI I DIJEVE**

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit, mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.

Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të nivelit të frekuentimit, aktivizimit në seminare, provimit të ndërmjetëm, detyrave të kursit, provimit përfundimtar, në % të përcaktuara në programin e lëndës si dhe kërkesa specifike të sqaruara në syllabusin e lëndës përkatëse.

Komunikimi i rezultateve dhe ankimi - Rezultatet e provimeve komunikohen nga pedagogët e lëndës brenda (3) tri ditëve pas kryerjes së provimit .

Ankimimi – Përfshin ankimin në momentin e komunikimit të rezultatit dhe në rast se studenti nuk bie dakort, ka të drejtën që brenda 2 (dy) diteve të paraqesë ankesën me shkrim, pranë sekretares së ciklit dhe fakultetit ku është i/e regjistruar për trajtimin e ankimit nga Dekani. Dekani brenda ditës së 6 (gjashtë) pas provimit duhet të komunikojë vendimin e tij.

### 3) **PROVIMET**

- 1) Sezonet e provimeve: UMSH organizon normalisht 3 sezone provimesh në vit (të dimrit, verës dhe vjeshtës).
- 2) Rektorati ka të drejtën të organizojë sezone provimesh të tjera, në përputhje me nevojat, udhezimet dhe rregulloret e brendshme të UMSH, për provime të mbartura (të pashlyera në sezonet dhe vitet e mëparshme).
- 3) Sezonet standarde të Provimeve gjatë një viti akademik të studimit: Studentit, UMSH i lejon mundësinë e marrjes pjesë në provimet për çdo lëndë të programuar në vitin përkatës akademik, dy herë brenda një viti akademik, në sezonin e dimrit dhe vjeshtë ose në sezonin e verës dhe vjeshtë pa pagesa shtesë.
- 4) Provimet e mbartura nga sezonet ose vitet paraardhëse (Quhen të mbartura kur janë kaluar dy mundësi për dhënie të një provimi): UMSH i lejon studentit mundësinë e marrjes pjesë në sezonet e provimeve të mbartura në sezonin e vjeshtës ose dhe sezone të tjera me vendime rektorati. Në këtë rast do paguhet penalteti prej 2200 (dy mijë e dyqind) Lekë për çdo regjistrim për provim të mbartur. (Nuk penalizohen studentët e transferuar për provimet që i përkasin viteve paraardhëse sipas vendimeve të Komisioneve të transferimeve për shlyerjen e tyre në dy herët e para).
- 5) Përmirësimi i notës: Studenti i sistemit Bsc gëzon të drejtën e përmirësimit deri në 5 lëndë dhe studentit i sistemit Master deri në 2 lëndë, kundrejt pagimit të tarifës prej 2200 (dy mijë e dyqind) Lekë për çdo provim të regjistruar. Në çdo rast kur studentit hyn në provim për përmirësimin e notës, mbetet në fuqi nota me të cilën vlerësohet në fund. Keto provime mund të jepen në sezonin e vjeshtës ose sezonet ekstra të miratuara nga Rektorati.

### 4) **KALIMI NË VITIN PASARDHËS**

Për kalimin nga viti i parë në vitin e dytë të studimeve studentit duhet të rezultojë kalues në së paku 30 kredite (ECTS) (mbi gjysmën e provimeve vjetore).

Për kalimin nga viti i dytë në të tretin nevojitet që studentit duhet të rezultojë kalues në së paku 60 kredite (ECTS), 30 kredite për secilin vit, (mbi gjysmën e provimeve të çdo viti paraardhës).

Tel: +355 68 50 47301 • +355 69 62 28401

E-Mail: Informacion: [info@umsh.edu.al](mailto:info@umsh.edu.al) • Aplikime: [aplikim@umsh.edu.al](mailto:aplikim@umsh.edu.al)

[www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)

Pas përfundimit të sezonit të provimeve në vjeshtë, studenti që nuk ka marrë së paku 30 kredite (ECTS) nga viti i parë ose 60 kredite (ECTS) nga viti i parë dhe i dytë përkatësisht 30 kredite (ECTS) në secilin vit, do të rezultojë **Jo-Kalues** dhe do të ri-regjistrohet në të njëjtin vit mësimor, duke paguar përsëri tarifën e regjistrimit dhe penaltetet përkatëse. Në këtë rast studenti do të duhet të rifrekuentojë lëndët për të cilat nuk i është lejuar futja në provim për shkak të mosfrekuentimit si dhe të rijapë provimet për të gjitha lëndët që do të ndjekë e ato të vlerësuara jo-kalues. Penaltetet përkatëse në këto raste janë si më lart për lëndët që do rifrekumentohen dhe për provimet e mbartura.

#### 5) **ZGJEDHJA E LËNDËVE**

Në çdo program studimi ka lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Në rastin e lëndëve me zgjedhje, studenti ka të drejtën dhe detyrimin që brenda dy javëve të fundit të semestrit paraardhës të programit të lëndëve me zgjedhje, të paraqesë kërkesën për zgjedhjen e tij, duke plotësuar formularin përkatës, pranë Sekretarisë Mësimore.

##### Ndërrimi i lëndëve me zgjedhje

Studenti ka të drejtë të ndryshojë zgjedhjen e tij, duke paraqitur kërkesën pranë Sekretarisë Mësimore, brenda dy javëve nga fillimi i semestrit ku është e programuar lënda me zgjedhje. Më pas lëndët me zgjedhje bëhen të detyrueshme dhe u nënshtrohen procedurave të parapara nga shkolla si të tilla.

#### **B. RESPEKTIMI I KODIT TË ETIKËS**

1) **BASHKËPËRFITIMI E RESPEKTI NË AUDITOR:** Kodi i Etikës kërkon që të gjithë studentët e pedagogët të sillen me respekt ndaj njeri-tjetrit, ndaj auditorit dhe kolegëve e bashkëstudentëve, duke synuar përfitimin maksimal individual të dijeve, pa shqetësuar e penguar përfitimin e dijeve të tjerëve në auditor. Dëmtimi i mbarëvajtjes së mësimin mund të bëhet shkak për thyerje të kodit të etikës. Ndalohet përdorimi i telefonave gjatë orareve të mësimin.

2) **KOPJIMI:** Studenti që kapet duke kopjuar në çfarëdo lloj provimi, mësimor apo përfundimtar, përjashtohet nga provimi dhe vlerësohet me notën 4 (katër). Akti vlerësohet automatikisht si thyerje e kodit të etikës.

3) **PLAGJIATURA:** Studenti të cilit i rezulton e kopjuar detyra e kursit ose diploma, pas verifikimeve të pedagogëve të Shkollës, vlerësohet me notën 4 (katër). Akti vlerësohet automatikisht si thyerje e kodit të etikës.

4) **MASAT NE THYERJE TE KODIT TE ETIKES:** Në çdo njërin nga rastet masat janë të shkallezuar si me poshte:

1. **Herën e parë:** "Tërheqje vëmendje për shkelje të Etikës" dhe emri i studentit regjistrohet në shënimet e Këshillit të Etikës së Shkolles.
2. **Herën e dytë:** "Paralajmërim me përjashtim nga shkolla për shkelje të Etikës" dhe emri i studentit regjistrohet në shënimet e Këshillit të Etikës së Shkolles. Kjo masë shoqërohet edhe me një penaltetet pagese prej 11000 lekë.
3. **Herën e tretë:** "Përjashtim nga shkolla për vitin akademik që ndodh shkelja" dhe emri i studentit regjistrohet në shënimet e Këshillit të Etikës së Shkolles. Kjo masë shoqërohet edhe me një penaltetet pagese prej 60000 lekë dhe me reregjistrim në të njëjtin vit studimi, në vitin e ardhshëm akademik me të gjitha detyrimet financiare të një viti të ri.

#### **C. RREGULLA ADMINISTRATIVE**

1) **KOMUNIKIMI në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë:** Në UMSH komunikimi nëpërmjet e-mailit zyrtar të shkollës është komunikim zyrtar. Të gjithë studentët e regjistruar në UMSH, pajisen me adresën elektronike të dedikuar dhe e aktivizojnë atë menjëherë me fillimin e vitit akademik. Kjo adresë përbën

Tel: +355 68 50 47301 • +355 69 62 28401

E-Mail: Informacion: [info@umsh.edu.al](mailto:info@umsh.edu.al) | Aplikime: [aplikim@umsh.edu.al](mailto:aplikim@umsh.edu.al)

[www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)



edhe mjetin e komunikimit për procesin mësimor (Klasat Virtuale) dhe atë administrativ (Njoftime, kërkesa, shpallje, etj.) Komunikimet nga adresa të tjera nuk do të konsiderohen.

2) **MJEDISËT E Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë:** Të gjithë auditorët, sallat e mësimit e leximit, laboratorët dhe bibliotekat janë të hapura dhe në funksion të studentëve çdo ditë të javës nga ora 08:00 deri në 21:00. Studentët janë të detyruar të mirëmbajnë dhe të mos dëmtojnë bazën materiale, pronë e Shkollës, në të gjitha mjediset e saj. Dëmtimi nga keqpërdorimi apo humbja e tyre, ju detyron të çdëmtoni dyfishin e vlerës së tyre.

3) **PËRDORIMI I BIBLIOTEKËS** është në dispozicion të të gjithë studentëve të Shkollës, të cilët kanë të drejtën e përdorimit të librave, materialeve, teksteve, si dhe librarisë elektronike në ambientet e shkollës dhe në përdorim personal. Në rastin e fundit, libri apo teksti i nevojshëm merret në Bibliotekën e Shkollës kundrejt ID-së së studentit dhe shënimeve përkatëse në dosjen e tij, si dhe përdoret për një periudhë jo më të gjatë se 2 javë. Çdo vonesë penalizohet me një pagesë prej 100 lekësh për ditëvonese. Librat kthehen në Bibliotekë brenda afatit, të padëmtuar dhe në formën e tyre fillestare. Materialet, tekstet dhe librat janë pronë e Shkollës dhe në rast të dëmtimit apo humbjes së tyre studentët do të çdëmtojnë dëmin, duke paguar pesëfishin e vlerës së tyre.

#### 4) **ORARET E MËSIMIT**

**Orari Mësimor,** i leksioneve, seminareve, punëve laboratorike dhe i të gjithë aktiviteteve mësimore dhe shkencore njoftohet zyrtarisht nga Sekretaria Mësimore nëpërmjet disa formave si: publikimi në formë elektronike në ambientet e shkollës dhe në faqen e internetit të Shkollës, në formë të printuar e prezantuar në vende të dukshme; si dhe duke e dërguar në adresën elektronike të çdo studenti.

**Ora e mësimit:** Leksionet dhe seminarat fillojnë në orën e plotë (p.sh. 09:00) dhe zgjasin 50 minuta. Ndërmjet orëve ka një pushim 10 minutash. Studentët duhet të jenë në sallën e mësimit para fillimit të leksionit apo seminarit. Pedagogu ruan të drejtën e vendimit të pranimit ose jo të studentit në sallën e leksionit ose seminarit pas fillimit të mësimit.

### D. TRANSFERIMI I STUDIMEVE

**Procedura** fillon me paraqitjen e kërkesës pranë Sekretarisë Mësimore, shoqëruar me dokumentacionin ligjor të kërkuar për këtë proces brenda afateve ligjore të shpallura nga MAS/Shkolla.

Dokumentacioni i paraqitur trajtohet nga komisionet e transferimeve të ngritura pranë fakulteteve, brenda 3 ditëve pune nga paraqitja e tyre dhe vendimi i bëhet me dije ditën e katërt pas paraqitjes së kërkesës.

**Vendimi i transferimit** përmban tri pjesë kryesore:

a) Vitin në të cilin klasifikohet të vazhdojë studimet aplikanti në bazë të listës së lëndëve me kreditet (ECTS'te) e paraqitura nga aplikanti, i cili përcaktohet sipas rasteve më poshtë:

- i. Në rastin e transferimeve nga një program i ngjajshëm, 31-60 kredite (ECTS) të ardhura e klasifikojnë në vitin e dytë të studimeve dhe mbi 61 kredite (ECTS) e klasifikojnë në vitin e tretë të studimeve.
- ii. Në rastin e transferimeve nga një program jo i ngjajshëm, kriteret e pranimit për percaktimin se në cilin vit studimi do transferohen, varet nga vendimi specifik i shpjeguar i Komisioneve të transferimit, i cili do marrë në konsideratë të gjitha kreditet (ECTS'te), që komisioni i gjykon si të ngjajshme me programin e shkollës sonë për të cilin aplikanti ka paraqitur kërkesë. Kjo shumë do jetë bazë për klasifikimin si në pikën (i).

b) Listën e lëndëve të pranuar e të konvertuara, sipas programit të shkollës shoqëruar me vlerësimin e krediteve (ECTS've) përkatëse dhe notave .

c) Listën e lëndëve me kreditet (ECTS-te) përkatëse për t'u plotësuar në shkollën tonë, të ndarë në dy grupe: (a) lëndë që duhen frekuentuar dhe (b) lëndë që duhen dhënë vetëm provim (janë vlerësuar me notën 4 ose kanë shënimin frekuentuar ose shënime të ngjajshme në listen e notave të paraqitura nga aplikanti).

d) Pas vendimit, studenti ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet, si çdo student tjetër i shkollës. Në rastet se në vendimin e komisioneve njihen lëndë të vitit të caktuar për t'u ndjekur, studentit do t'i reduktohet tarifa me 100 Euro, nëse ai paguan tarifën e plotë të studimit.

### E. MODALITETE TË PAGESAVE

**Tarifa e studimit, për të gjitha programet, në të gjitha ciklet e studimit të cilat ofrohen në UMSH, për vitin akademik 2024-2025 është sipas Aneksit të Vendimit Nr. 3, datë 02.07.2024 të Bordit të Administrimit.**

Tel: +355 68 50 47301 • +355 69 62 28401

E-Mail: Informacion: [info@umsh.edu.al](mailto:info@umsh.edu.al) • Aplikime: [aplikim@umsh.edu.al](mailto:aplikim@umsh.edu.al)

[www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)

TARIFA VJETORE mund të paguhet në një nga 2 (Dy) mënyrat e mëposhtme të cilat janë të parimbursueshme dhe të rimbursueshme si më poshtë:

**1. TARIFA VJETORE** e programit të studimit mund të paguhet në tre pjesë dhe sipas afateve të mëposhtme:

Tarifa e Regjistrimit (Kësti i parë ) është në vlerën prej 80 000 (tetëdhjetë mijë) Lekë dhe duhet paguar me nënshkrimin e kontratës dhe në asnjë rast më vonë se 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të saj në rastin e studentëve të rinj në UMSH. Në rastin e studentëve në vazhdim kjo pagesë duhet kryer para datës së deklaruar të fillimit të vitit akademik. Në rast mospagese sipas këtyre afateve studenti nuk e fiton statusin e studentit për vitin akademik. (Përjashtim nga ky detyrim bëjnë vetëm studentët që përfitojnë bursë të plotë). (Në çdo rast që studenti nuk tërhiqet brenda afateve të përmendura në këtë kontratë, atij i lind detyrimi i pagesës së Tarifës së regjistrimit).

Kësti i dytë është i përbërë nga 50 % e vlerës së pashlyer nga detyrimi i plotë i TARIFËS VJETORE për vitin akademik, i cili lind si detyrim për t'u paguar nga datat 1 - 15 janar të çdo viti akademik për shërbimin e ofruar për semestrin e parë. (Në çdo rast që studenti nuk tërhiqet me shkrim brenda Javës së 3 dhe të 4 të fillimit të vitit akademik.

Kësti i tretë përbëhet nga likuidimi total i pjesës së mbetur pa shlyer nga TARIFA VJETORE plus shumën e lindur nga rishikimet, detyrim i cili duhet paguar nga datat 15 Maj - 1 Qershor të çdo viti akademik si pagesë për shërbimin e ofruar në semestrin e dytë. (Në çdo rast që studenti nuk tërhiqet me shkrim brenda përfundimit të semestrit të parë akademik, atij i lind detyrimi i pagesës së Këstit të tretë.)

**2. Pagesa e plotë e TARIFËS VJETORE** të studimit nga momenti i regjistrimit deri në 15 ditë pas fillimit të vitit akademik i jep të drejtë studentit të përfitojë reduktim të pagesës me 10 % të vlerës së TARIFËS VJETORE (INDEKSIMI do të aplikohet edhe në këtë rast në periudhën e pagesës së fundit). Tejkalmi i afatit i humbet studentit të drejtën për të përfitur nga zbritja prej 10 %.

Përfitojnë nga kjo e drejtë vetëm ato studentë për të cilët tarifa është 200 000 (dyqindë mijë) Lekë. Nuk përfitojnë nga kjo e drejtë studentët të cilëve i është akorduar bursë ose tarifë preferenciale.

Mosshlyerja e detyrimeve brenda afateve e rëndon studentin me një pagesë shtesë prej 2200 (dymijë e dyqindë) Lekë në çdo rast vonese.

## F. BURSAT

Aplikimi për Bursë kryhet nëpërmjet plotësimit të kërkesës që vihet në dispozicion nga sekretaria, formularëve e dokumentacionit të kërkuar deri në 15 Korrik, dorezimi bëhet pranë sekretarisë së Bordit të UMSH.

Përfitimi i të drejtës së bursës në masa të ndryshme, pas trajtimit të kërkesave e dokumentacioneve mbështetëse nga një komision i ngritur pranë Bordit të UMSH, për këtë qëllim i njoftohet aplikantëve brenda 15 ditëve të para të fillimit të shkollës. Mosplotësimi me dokumentacionin e duhur si dhe deklarimi i rremë, automatikisht e rrezon kërkesën dhe **mashtrimi** e penalizon aplikantin me dyfishin e tarifës vjetore qysh nga fillimi i studimeve.

Humbja e të drejtës së bursës, ndodh në çdo rast, kur student i përfitues bëhet subjekt i çdonjerit nga penalitetet e mësipërme dhe vendimi ka fuqi prapavepruese që nga koha e fitimit të kësaj të drejte.

Studentët të cilët janë përfitues të bursave ose tarifave të reduktuar të ndryshme, kanë detyrim që të kontribuojnë sipas nevojave dhe kërkesave të UMSH.

## REKTORI

Akademik i Asociuar Prof. Dr. Adrian Civiçi

Tel: +355 68 50 47301 • +355 69 62 28401

E-Mail: Informacion: [info@umsh.edu.al](mailto:info@umsh.edu.al) / Aplikime: [aplikim@umsh.edu.al](mailto:aplikim@umsh.edu.al)

[www.umsh.edu.al](http://www.umsh.edu.al)

